



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 6811 Prot.

Tiranë, më 23.12. 2020

URDHËR

NR. 358, DATË 23.12:2020

PËR

**DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 313, DATË 20.10.2020 TË MINISTRIT TË
ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE
LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKO-SOCIAL”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 20 dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26 ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 313 datë 20.10.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pikat 3, 5 dhe 6 të kreut V, ndryshohen si vijon:

“3. Pas përzgjedhjes së vendit të punës nga kandidati, DRAP-i përkatës nxjerr aktin e emërimit të kandidatit në institucionin arsimor parauniversitar të përzgjedhur prej tij dhe nënshkruan kontratën e punës me të.

....

5. Në rastet kur vendi i punës është formuar nga më shumë se 1 (një) institucion arsimor parauniversitar, DRAP-i përkatës nxjerr aktin e emërimit dhe nënshkruan kontratën e punës sipas institucioneve arsimore parauniversitare të përcaktuara nga ZVAP për vendin e punës, në varësi të numrit të nxënësve. Punonjësi i Shërbimit Psiko-Social evidentohet në listëprezencën e institucionit arsimor parauniversitar publik me numrin më të madh të nxënësve.

6. Kandidati fitues paraqitet në institucionin arsimor parauniversitar publik, brenda 3 ditëve pune, nga data që ka përzgjedhur dhe ka nënshkruar kontratën e punës me DRAP-in përkatës. Nëse për arsye të ligjshme kandidati nuk mund të paraqitet në institucion

për të filluar marrëdhëniet e punës, duhet të njoftojë drejtorin e DRAP-it përkatës për shkakun e mosparaqitjes dhe të kërkojë zgjatjen e afatit të paraqitjes në institucion.

b) Pika 1 e kreut VI, riformulohet si vijon:

“1. Me propozim të drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar publik, drejtori i DRAP-it merr masën e pezullimit ndaj psikologut/punonjësit social, në rastet kur:

a) gjykata vendos ndaj tij, masë të sigurimit personal deri në vendimin e formës së prerë;
b) ka nisur procedura disiplinore dhe vlerësohet se qëndrimi i tij në punë përbën rrezik të zhdukë, të vështirësojë, të manipulojë ose të bëjë të pamundur marrjen e provave që lidhen me procedurën disiplinore.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Evis KUSHI

